

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"e-FRUTZA" SHPK
EMERTIMI-OBJEKTI-QENDRA-KOHEZGJATJA

NENI 1-Emërtimi i shoqërisë

Shtetasi shqiptar:

Gentjan Zotaj i biri i Fadil dhe Natasha lindur në Ballsh më 16/03/1984 me ID I40316120A, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, dhe banues në Tiranë në adresën rr "Bajran Curri 1845/038, Tiranë" është ortak i vetëm i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "**e-FRUTZA**" sh.p.k. Shoqëria është person juridik dhe do ushtrojë veprimtarinë në bazë të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 «Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare» i ndryshuar.

NENI 2-Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do jete si vijon:

- Perdorimi i teknologjise per menaxhimin online te porosive dhe dorezimin lidhur me Fruta dhe produkte te tjera
- Perdorimi i teknologjise per menaxhimin online te porosive dhe dorezimin e produkteve te ndryshme
- Perdorimi i teknologjise per menaxhimin e operacioneve ne terren lidhur me sherbime postare
- Perdormin e sherbimeve e-commerce
- Shitje online per fruta dhe produkte te tjera

NENI 3-Kohëzgjatja e veprimtarisë

Shoqëria do te ushtrojë aktivitetin tregtar do jetë subjekt i të drejtës shqiptare pa afat të përcaktuar.

Me vendim te ortakut të vetëm afati i mësipërm mund te ndryshojë ose shoqëria mund të shkrihet.

NENI 4-Vula

Shoqëria do të ketë vulën e vet në formën e përcaktuar nga ortakut

NENI 5 -Selia e shoqërisë

Shoqëria "**e-FRUTZA**" Sh.p.k ka qendrën në "Tiranë, Njësia Administrative nr.5, Rruga Prokop Mima, Pallati Universal, Zona Kadastrale 8270, Nr Pasurie 3" dhe do te ketë të drejtë të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria mund të krijojë agjenci, zyra përfaqësimi, qendra dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 6- Kapitali regjistruar

Kapitali i shoqërisë është LEKE 100.000 (njëqind mijë lekë) dhe është kapital i ortakut të vetëm. Kapitali është i ndare në 1 kuota me vlere 100.000 lekë (njëqind mijë lekë).

Kapitali i shoqërisë mund te rritet apo zvogëlohet me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 7-Transferimi i kuotave

Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme.

1.Kuotat e kapitalit të shoqërisë si dhe të drejtat qe rrjedhin prej tyre me vendim të ortakut të

vetëm mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

c) dhurimit; (si personave që kanë lidhje gjaku me ortakun e vetëm ashtu edhe të tjerëve pa lidhje gjaku)

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të behet me shkrim.

NENI 8–Ortaku i vetëm

Shoqëria zotërohet nga një ortak dhe të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortakun i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortakun i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
- Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- Investimet e reja;
- Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria vendos ndryshe.

NENI 9–Drejtimi dhe administrimi

9.1 Shoqëria tregtare " **e-FRUTZA** " sh.p.k do drejtohet nga një administrator që emërohet me vendim të ortakut të vetëm.

Administrator i Shoqërisë duke filluar nga data e sotme për tre vitet në vazhdim (17/05/2022 deri 17/05/2025) do të jetë ortakun i vetëm **Gentjan Zotaj**

9.2 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga ortakun i vetëm;
- përfaqëson shoqërinë tregtare;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecuresë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm për miratim;
- krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raporton përpara ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

9.3 Ortaku i vetëm mund ta shkarkojë administratorin në çdo kohë. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund ta përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

9.4. Administratori do shpërblehet sipas përcaktimit të ortakut të vetëm në përputhje me parashikimin e nenit 97 të ligjit nr.9901 date 14.04.2008.

9.5 Administratori ka të drejtë të caktojë dhe revokojë persona të tretë në mungesë dhe për llogari të tij.

NENI 10—Kontrolli i brendshëm

Shoqëria tregtare organizon kontrollin e brendshëm me një kontabël të miratuar, i cili është përgjegjës përpara kësaj shoqërie për dëmet që mund të shkaktojnë nga moskryerja në rregull e detyrës së tij.

NENI 11—Bilanci dhe të ardhurat

Veprimet ekonomike e financiare të shoqërisë mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti përveç rasteve e urdhrave të veçanta të ortakut të vetëm të saj. Në fund të çdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabël me rezultatin ekonomik HUMBJE FITIME.

Bilanci kontabël miratohet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe pas përcaktimit të detyrimeve fiskale pjesa që mbetet i jepet për përdorim Ortakut të vetëm të saj.

NENI 12—Shpërbërja e shoqërisë

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak. Në rast shkrirje të shoqërisë, Ortaku i vetëm vendos mbi mënyrat e likuidimit dhe cakton një ose më shumë likuidatorë duke iu përcaktuar edhe detyrat.

Në rastin e likuidimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shënimi:

SHOQERI NE LIKUIDIM E SIPER.

Administratori regjistron prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".


NENI 13 - Dispozita përfundimtare

Për sa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut do i referohet plotësimeve të bëra nga ORTAKU I VETEM.

Shoqëria "**e-FRUTZA**" shpk. do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare dhe do ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislacionit shqiptar në përgjithësi dhe normat e këtij statuti. Ky statut nënshkruhet prej ortakut në datë 17/05/2022.

ORTAKU I VETEM

Gentjan Zotaj



5/17/2022